



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 18 Mars 2021

Nr: 168

**VENDIM**

**PËR MIRATIMIN E REZULTATIT TË SHORTIT PËR PËRCAKTIMIN E RENDITJES  
SË SUBJEKTEVE ZGJEDHORE NË FLETËN E VOTIMIT PËR ZGJEDHJET PËR  
KUVEND TË DATËS 25 PRILL 2021**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, nenit 98, pika 5 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 10, datë 11.03.2021 të Komisionit Rregullator “Për procedurën e hedhjes së shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore në fletën e votimit për zgjedhjet në Kuvend”,

**V Ë R E J:**

Në mbështetje të nenit 98, pika 5 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve organizon hedhjen e shortit për detyrimet që rrjedhin nga ky nen, menjëherë sapo të ketë përfunduar regjistrimi i listës shumëmemërore në KQZ. Rregullat për hedhjen e shortit përcaktohen me akt normativ të KQZ-së.

Në zgjedhjet për Kuvend, shorti organizohet duke përfshirë në short të gjitha partitë politike që kandidojnë më vete, koalicionet zgjedhore dhe kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit që janë regjistruar si të tillë në të gjitha zonat zgjedhore.

Në përfundim të afatit për regjistrimin e listave shumëmemërore në KQZ, janë regjistruar gjithsej dy koalicione zgjedhore, koalicioni me shkronja nistore (PD-AN) dhe koalicioni me shkronja nistore (ABEOK), 10 (dhjetë) parti politike që garojnë më vete dhe 5 (pesë) kandidatë të propozuar nga zgjedhësit për bashkitë Tiranë, Shkodër, Dibër, Gjirokastrë, Lezhë.



## PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe nenit 98, pika 5 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 10, datë 11.03.2021 të Komisionit Rregullator “Për procedurën e hedhjes së shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore në fletën e votimit për zgjedhjet në Kuvend”

## V E N D O S :

1. Të miratoj rezultatin e shortit duke përcaktuar numrin rendor që do të ketë çdo subjekt zgjedhor në fletën e votimit, sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Illirjan CELIBASHI**





## SHORTI PËR NUMRIN RENDOR NË FLETEN E VOTIMIT

NUMRI	SUBJEKTI
1	PARTIA SOCIALDEMOKRATE
2	PARTIA BALLI KOMBËTAR
3	PARTIA LËVIZJA DEMOKRATIKE SHQIPTARE
4	PARTIA BINDJA DEMOKRATIKE
5	KOALICIONI ALEANCA BASHKIMI POPULLOR - EMIGRACIONI - ORA E SHPRESËS DHE KONSERVATORËT (ABEOK)
6	PARTIA LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM
7	PARTIA NISMA THURJE
8	PARTIA LËVIZJA E RE
9	KOALICIONI PARTIA DEMOKRATIKE - ALEANCA PËR NDRYSHIM (PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJ-PDK-LZHK-PLL- FRD-BLD-PBKD-PBD-PKD)
10	ALEANCA DEMOKRACIA E RE
11	PARTIA LËVIZJA PËR NDRYSHIM
12	PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË
13	KANDIDAT I PROPOZUAR NGA ZGJEDHËSIT

Miratuar me vendimin e KSHZ nr.168, datë 18.03.2021

